



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 17 shkronja k) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, Rregullores Komunale për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, neneve 14 dhe 19 paragrafi 1.11 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, sipas kërkesës nr.208/24 të datës 22.11.2024 të Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, të proceduar në Komunën e Podujevës përmes Kërkesës nr.prot.02-120/010-0075543/24 datë 22.11.2024, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 11 dhjetor 2024, miratoi këtë,

V E N D I M

PËR SUBVENCIONIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHËRBIMET E VARRIMIT TË QYTETARËVE ME VENDBANIM TË PËRHERSHËM NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet kërkesa e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevës sipas të cilës Komuna e Podujevës, për qytetarët me vendbanim të përhershëm përkatësisht personat që vdesin dhe varrosen në territorin e saj, bënë subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit për periudhën deri më 31 dhjetor 2026.

Neni 2

1. Për çdo të vdekur për të cilin në bazë të ekzaminimeve mjekësore në pajtim me dispozitat ligjore është konstatuar vdekja, bëhet subvencionimi i shpenzimeve për shërbimet e varrimit nga Bashkësia Islame përkatësisht Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevë, që përfshijnë: transportin e kufomës, fletëljajmrimet (afishet), dërrasat, piramidën, pastrimin e kufomës, mbulesën e kufomës dhe qefinin.

2. Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevë kërkesës për kompensim të shërbimeve përkatëse sipas çmimore, i bashkëngjijt edhe konstatimin e vdekjes nga mjeku, dhe raportin e kryerjes së shërbimeve të vërtetuar-nënshkruar edhe nga ndonjëri prej familjarëve të ngushtë të të vdekurit (kopja ose numri i letërnjoftimit).

Neni 3

Autorizohet Kryetari i Komunës, të lidhë Marrëveshje Mirëkuptimi me Këshillin e Bashkësisë Islame në Podujevë, në cilësinë e subjektit të vetëm për ofrimin e shërbimeve sipas këtij vendimi, përmes së cilës definohen më në detaje obligimet dhe përgjegjësitë.

Neni 4

Subvencionimi bëhet nga mjetet buxhetore përkatësisht të hyrat vetanake-kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Neni 5

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është çmimorja e shërbimeve.

Neni 6

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtorinë e Administratës si dhe Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave.

Neni 7

Ky vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren 06/2021.

Nr.Prot. 01-400/01-0078829/24
Podujevë, datë; 11 dhjetor 2024



Çmimorja

e ofrimit të shërbimeve të varrimit nga Këshilli i Bashkësisë Islame - KBI, Podujevë

- 1. Transporti i kufomave** (bartja e kufomës nga shtëpia deri në Xhami dhe përcjellja deri në varreza; bartja nga Aeroporti në familje në rastet kur kufomat sjellën nga jashtë vendit; bartja e kufomës nga QKUK deri te familja në rastet kur ndërrojnë jetë në QKUK si dhe transport shtesë varësisht kërkesës së qytetarit/familjarit; transporti i nëpunësve të KBI dhe mjeteve të punës si dhe dezinfektimin i veturës/automjetit).....**60 €**
 - 2. Fletë lajmërimi** (afishe).....**20 €**
 - 3. Dërrasat** (dërrasat me të cilat mbulohet kufoma pas lëshimit në varr, me dimensione; gjerësia 200 cm, gjatësia 115 cm dhe trashësia 05 cm).....**40 €**
 - 4. Piramida** (Dërrasa me mbishkrimin e të dhënave të të vdekurit).....**20 €**
 - 5. Vend pastrimi i kufomave** (banjë moderne për pastrimin e kufomave, mirëmbajtja e vend pastrimit dhe objektit përcjellës – rrymë, ujë detergjente e të tjera).....**20 €**
 - 6. Pastrimi i kufomave** (pastrimi, mbështjellja dhe përgatitja e kufomës sipas rregullave Islame nga personi përgjegjës).....**55 €**
 - 7. Mbulesa për mbështjelljen e kufomës**.....**10 €**
 - 8. Qefini** (Pëlhura për mbështjelljen e kufomës ku përfshihen dorezat higjienike, pambuku dhe sapuni).....**25 €**
- Totali i shpenzimeve.....250 €**